



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:305201

Datë: 29.11.2024

Numri i dokumentit: 06525429

K.DH.SH.II.nr.1097/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Satech” SH.P.K., me seli Pejë, rruga “Hoxhë Tasini” nr.34, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Blerim Ademaj avokat nga Peja, kundër debitorit “Hotel Albi” SH.P.K., me numër unik identifikues 811572727, me seli në Pejë, rruga “Tahir Zemaj”, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2253/23 i datës 07.02.2024, me datë 27.11.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e kreditorit Satech shpk, me seli Pejë, rruga “Hoxhë Tasini” nr.34, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2253/23 i datës 07.02.2024, PRISHET dhe çështja i kthehet Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë, në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar, KPPP.nr.2253/23 të datës 07.02.2024, në pikën I të dispozitivit ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “Hotel Albi” SH.P.K., dhe ka anuluar urdhrin përmbarimor P.nr.3301/23 të datës 07.12.2023, të Përmbaruesit Privat Blerim Baloku, si dhe ka përfunduar në tërësi përmbarimin në këtë çështje përmbarimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori "Satech" SH.P.K., me seli Pejë, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo objektiv të gjendjes faktike dhe provave, si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata ta aprovojë ankesën e kreditorit të prishet aktvendimi i atakuar, si dhe të pranohet si i bazuar propozimi për përmbarrim i kreditorit.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale- Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori "Satech" SH.P.K., me seli në Pejë, me datën 07.12.2023 ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitorit "Hotel Albi" SH.P.K., me seli në Pejë, në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr.901-23 e datës 11.09.2023, në vlerë prej 5,800.00 Euro.

Përmbarruesi privat, duke vepruar sipas propozimit për përmbarrim, me urdhrin përmbarrimor P.nr.3301/23 dt.07.12.2023 ka lejuar përmbarrimin, duke e detyruar debitorin që t,ia paguaj kreditorit shumën e borxhit prej 5,800.00€, brenda 7 ditësh nga dita e pranimi të urdhrin përmbarrimor, si dhe shpenzimet e procedurës, ashtu që të gjitha detyrimet të realizohen përmes bllokimit të të gjitha llogarive bankare të debitorit ndërsa nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogaritë e tij bankare, zyra përmbarrimore të zbatojë përmbarrimin përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme të debitorit.

Debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin për përmbarrim duke theksuar se faturat e dërguara nga kreditori janë të pa pranueshme ngase të njëjtat nuk i plotësojnë kriteret ligjore për të qenë dokumente të besueshme, për faktin debitori nuk ka pranuar shërbime nga kreditori dhe faturat janë të panjohura për debitorin pasi që kreditori nuk i ka ofruar të njëjtat për t'i konfirmuar dhe debitori nuk ka njohuri se kush i ka nënshkruar.

Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor P.nr.3301/23 i datës 07.12.2023 të hedhet poshtë si i papërmbartueshëm.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të cekura në prapësim, duke theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit pasi që të njëjtat nuk i ka mbështetur në prova. Tutje ka shtuar se debitori në prapësim nuk kundërshton borxhin por vetëm nënshkrimin e faturës, mirëpo për këtë pretendim nuk ka ofruar dëshmi. Kreditori pretendon se ofrimi i shërbimeve nga kreditori tek debitori vërtetohet sipas kontratës së nënshkruar me datë 07.02.2023 lidhur me ofrimin e shërbimeve të caktuara nga kreditori si “Kompania” për debitorin si “Klient” për 36 muaj, andaj gjykatës i ka propozuar që prapësimi të refuzohet në tërësi si i pabazuar dhe urdhri përmbartimor të vërtetohet si i bazuar dhe i ligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të shkresave të lëndës, prapësimi dhe përgjigjes në prapësim vendosi si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se Fatura Nr.901-23 e datës 11.09.2023, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbartim, nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret nuk ka arritur afatin për pagesë dhe nuk është në përputhje me dokumentin në bazë të cilit është lëshuar përkatësisht me kontratën për shërbime të lidhur nga palët me datë 07.02.2023, ku sipas pikës 4 të kontratës përcaktohet se *“4.1 Pagesa mujore është 200 euro në muaj duke përfshirë mirëmbajtjen mujore dhe pagesën për shërbime të përfunduara më lartë neni 1 pika 1 e cila është ndarë në 36 këste”*. Më tej në arsyetim ka theksuar se gjykata vlerësoi ligjshmërinë e urdhrit përmbartimor në kuptim të nenit 30 të Ligjit NR. 04/L139 për procedurën përmbartimore i cili përcakton: *“Kur nga dokumenti i besueshëm nuk shihet se a është bërë e kërkueshme kredia, atëherë përmbartimi caktohet vetëm në qoftë se kreditori paraqet deklaratë me shkrim se kredia e tij është bërë e kërkueshme duke u treguar edhe dita për një gjë të tillë”* dhe nenit 71 par. 1 pika 1.7 i cili përcakton se *“1.7. kushti i përcaktuar në dokumentin përmbartues nuk është përmbushur, përveç nëse parashikohet ndryshe me ligj”*.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës

kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n), neni 183 të LPK-së, lidhur me nenin 21 dhe 27 të LPP-së.

Në këtë kontekst, kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë nuk ka analizuar saktë shkresat e lëndës si dhe nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike kur e ka vlerësuar dokumentin e besueshëm-Faturën Nr.901-23 të datës 11.09.2023 në bazë të së cilës është lejuar urdhri përmbarimor, me arsyetimin se kjo faturë nuk e ka arritur afatin për pagesë, mirëpo nga vlerësimi i gjykatës së shkallës së dytë evidentohet se fatura lëndore ka të përshkruar afatin e pagesës me datë 20.09.2023, ndërsa propozimi për përmbarim është paraqitur me datë 07.12.2023 pas arritjes së afatit për pagesë/maturimit. Gjykata e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vlerësuar afatin e arritjes për pagesë duke u bazuar në kontratën për shërbime të lidhur nga palët me datë 07.02.2023 pasi në rastin konkret kjo kontratë nuk përbën dokument përmbarues. Andaj, edhe nga këto arsye është dashur që aktvendimi i atakuar të anulohet dhe çështja t'i kthehet të njëjtës gjykatë në procedim të sërishëm.

Meqenëse Dhoma e shkallës së parë nuk ka shqyrtuar drejtë çështjen, gjegjësisht lidhur me konstatimin në faturë, me qëllim të harmonizimit të shkresave në lëndë, në riprocedurë Dhoma e shkallës së parë udhëzohet që të bëjë eliminimin e shkeljeve të dispozitave të procedurës përmbarimore në pajtim me vërejtjet e paraqitura, ashtu që duhet të vlerësoj nëse fatura i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm konform dispozitave ligjore të LPP-së, e pas kësaj të marr vendim të drejtë dhe të ligjshëm konform dispozitave të LPP-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.1097/24 me datë 27.11.2024

Gjyqtari
Krenar Berisha